

**Data 03.07.2025**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT:**

*“Sistemim Asfaltim rruga Mardakajve”.*

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime  
riparimi rrugësh - 45233142-6**  
**VLERA E FONDIT LIMIT:**

4 053 499 (katër milion e pesëdhjetë e tri mijë e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH  
dhe 4 864 199 (katër milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e njëqind e nëntëdhjetë e  
nëntë) lekë me tvsh.

**Për vitin 2025:** 1 500 000 (një milion pesëqind mijë) lekë me tvsh.

**Për vitin 2026:** 2 000 000 (dy milion) lekë me tvsh.

**Për vitin 2027:** 1 364 199 (një milion e treqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e njëqind e  
nëntëdhjetë e nëntë) lekë me tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c  
dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të  
prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Malesi e Madheka  
hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve  
për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të  
VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): Sipas Shtojces 7.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të tre viteve të fundit (2022- 2023 - 2024) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore , të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivit . Shenim: Ne respektojmë të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ” Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43, pika 4, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse dy bilancet e njëpasnjëshme nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislationit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 ”Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 ”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ”Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, ”Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 ”Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, etj.

2.2.2. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022- 2023 - 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor)..

**Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetësinë e informacionit te paraqitur ne zbatim te Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”.**

**Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.**

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u bazuar ne Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” etj.

### **2.3.Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1Për të provuar përvojën e mëparshmeofertuesi duhet të dorezojë:

1- Punë të ngjashme, për 1 (një) kontratë të vetme në një vlerë jo më të vogël se 30 % e vleres limit te objektit qe prokurohet, të realizuar gjatë pese viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Ose

2- Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera limit e objektit që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30 % të vlerës së fondit

limit, për një objekt të vetëm, ose sa vlera e fondit limit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Mbeshtetur në rendesine e objektit të prokurimit, vlerën e fondit limit të venë në dispozicion, tipologjinë e punimeve të ndërtimit etj.

2.3.2. Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të Kontrates.

a. License profesionale sipas modelit të leshuar nga Ministria përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, e vlefshme me kategorite:

N.P – 1 A “Punime gjurmimi në tokë”.

NP - 4 A “Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.”

NS - 18 A Punime topogjeodezike.

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë përkatëse sipas legjislacionit në fuqi, në plotësim të liçencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

- **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për liçencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në nenin 18, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, si dhe në Vendimin nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies së liçencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, qeshtrojnë veprimtarinë e ndërtimit”, pikat e liçencës dhe kategoritë me klasifikimet përkatëse caktohen duke u mbështetur në punimet e parashikuara në preventivin e objektit dhe në vlerën totale të punimeve për secilën kategori.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë liçencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve sipas preventivit bashkëngjitur DST dhe konkretisht:

| Nr. | Kategoria e lic. | Zërat në preventiv                                                                                            |
|-----|------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1   | NP – 1 A         | Zëri 2,3                                                                                                      |
| 2   | NP- 4 A          | Sipas llojit të objektit- <b>Rrugë</b> , autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale |
| 2   | NS – 18 A        | Sipas llojit të objektit, e nevojshme për rilevimin e objektit                                                |

2.3.3 Ofertuesi duhet të jetë i pajisur me Certifikatë:

SSH/EN/ISO 9001:2015 - Certifikatë për sistemin e menaxhimit të cilësive;

SSH/EN/ISO 45001:2018 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)

Certifikatat duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të perkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar, dhe në përputhje me natyrën e objektit që tenderohen dhe të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në emër të ofertuesit.

Në rast bashkimi operatorësh, kjo certifikata duhet të ketë secilin operator ekonomik.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.4 Ofertuesi duhet të ketë një punësim mesatar jo më pak se 11 (njemdhjetë) punonjës (numër i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për kryerjen e punimeve në kohë, sipas analizës, bazuar në preventivin dhe grafikun e punimeve), për periudhën e fundit objekt deklarimi. Kjo do të vërtetohet me:

-Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën përkatëse;

-Listë pagesat e punonjësve për periudhën përkatëse të konfirmuar nga Administrata Tatimore (në formë elektronike);

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualit teknik të mënyrës së punës së punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (“për llogaritja e oreve të punës së punimeve të nevojshme”), Kodin Punes në RSH, si edhe bazuar në dosmoshmerinë e realizimit sa më shpejt të objektit dhe konkretisht rezultojnë 7 punëtore të thjeshtë numer i cili duke u mbledhur me drejtuesit teknik dhe personelin mbështetës sipas pikës 2.3.6 japin numrin 11.

2.3.5 Ofertuesi duhet të ketë drejtues teknik në licencën e zbatimit të punimeve, të pakten:

a. 1 (një) Ing. Ndërtimi

b. 1 (nje) Ing. Topograf

Per drejtuesit teknik si me lart, ofertuesi duhet te paraqese kontratat e punes, diplomat dhe CV.

(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

**Argumentimi:**Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Inxhinieret e kerkuar ne piken 2.3.5 jane ne perputhje me licencat e kerkuar ne piken 2.3.2.

a. 1 (nje) Ing. Ndertimi (Ne preventiv parashikohen punime mirembajtje dhe riparimi rruges)

b. 1 (nje) Ing. Topograf ( I nevojshem per rilevimin e objektit)

2.3.6. OE ofertuesi duhet te kete te perfshire ne stafin e tij, te certifikuar nga një organ i akredituar çertifikues personeli (Trup Certifikues), si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë minimumi per periodhen e fundit objekt deklarimi, jo me pak se:

a. Teknik ndertimi 1 (nje)

c. Karpentier 1 (nje)

Per punonjesin teknik ndertimi duhet te paraqitet kontratat e punes , cv, dokumenti certifikues i siperperkerkuar dhe dokumenti qe verteton kualifikimin (deftese dhe/ose diplome).

(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Njësia e Prokurimit duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve; makineritë që do të kërkohen për realizimin e punimeve (Shtojca 8) si dhe Preventivin e Punimeve shtron nevojën që Ofertuesit të kenë të punësuar punonjesit e mesiperm, me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Numri i këtyre punonjësve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”.

| Nr. | Specialisti                | Lidhja me punimet ne zerat e preventivit                                               |
|-----|----------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------|
| 1   | Teknik ndertimi<br>1 (nje) | Per te kontrolluar punen ndertimore dhe per te dhene udhezime te ndryshme per punimet) |
| 4   | Karpentier<br>1 (nje)      | Zeri i 9-te i preventivit.                                                             |

2.3.7. OE ofertuesi duhet te kete te perfshire ne stafin e tij, te certifikuar nga një organ i akredituar certifikues personeli (Trup Certifikues), jo me pak se:

a. Shofer 4 (kater)

b. Manovrator 5 (pese)

Per keta te paraqiten kontratat e punes , lejet e drejtimit dhe dokumenti certifikues i siperperkerkuar.

(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

**Argumentimi:**Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Njësia e Prokurimit duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve; makineritë që do të kërkohen për realizimin e punimeve (Shtojca 8) si dhe Preventivin e Punimeve shtron nevojën që Ofertuesit të kenë të punësuar punonjesit e mesiperm, me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Numri i këtyre punonjësve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”.

a. Shofer 4 (kater) – per drejtimin e mjeteve kamion, autobot uji, autobitumatrice sipas rendit te puneve.

b. Manovrator 5 (pese) - per drejtimin e mjeteve eskavator, grejder, rul me vibrim, rul me kompresor, asfaltoshtruese sipas rendit te puneve

2.3.8 Dëshmi për makinerite dhe paisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion ofertuesit, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, si me poshte (ne pronesi ose me qira):

| Nr. | Mjetet                                                                            | Sasia             | Gjendja                                       | Pershtatshmeria me preventivin (Justifikimi) |
|-----|-----------------------------------------------------------------------------------|-------------------|-----------------------------------------------|----------------------------------------------|
| 1   | Eskavator me goma 0.25m3                                                          | 1 cope            | Në pronësi ose me qera                        | Zeri 1                                       |
| 2   | Kamion me veteshkarkim min. 10 ton                                                | 4 cope            | Në pronësi ose me qera                        | Zeri nr.4,10                                 |
| 3   | Grejder                                                                           | 1 cope            | Në pronësi ose me qera                        | Zerat 5,6,7                                  |
| 4   | Rul me vibrim                                                                     | 1 cope            | Në pronësi ose me qera                        | Zerat 5,6,7                                  |
| 5   | Autobot uji                                                                       | 1 cope            | Në pronësi ose me qera                        | Zerat 5,6,7                                  |
| 6   | Rul me Kompresor                                                                  | 1 cope            | Në pronësi ose me qera                        | Zeri 8                                       |
| 7   | Asfaltoshtruese                                                                   | 1 cope            | Në pronësi ose me qera                        | Zeri 8                                       |
| 8   | Autobitumatrice                                                                   | 1 cope            | Në pronësi ose me qera                        | Zeri 8                                       |
| 9   | Vibrator Thellesie                                                                | 1 cope            | Në pronësi ose me qera                        | Zeri 9                                       |
| 10  | Betoniere 500l                                                                    | 1 cope            | Në pronësi ose me qera                        | Zeri 9                                       |
| 11  | Armatura                                                                          | 50 m <sup>2</sup> | Në pronësi ose me qera                        | Zeri 9                                       |
| 12  | Fabrike asfaltobetoni (e pajisur me leje mjedisore III.1.B, kur eshte ne pronesi) | 1 cope            | Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi | Zeri 8                                       |

(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit: Leje qakullimi, siguracion, kolaudim, taksa, Certificate/licence transporti si dhe kontraten përkatëse të qerave dhe licencen e transportit per te tretet (nese eshte me qera), e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. (Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fatura tatimore përkatëse fotot, ndersa per mjete te marra me qira krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet

te jete e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te punimeve deri ne perfundimin e plote te punimeve. (Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)

b) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij. (Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)

c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës deklaron se drejtuesit teknik të përfshirë në licencën e zbatimit të punimeve, të shoqërisë së tij nuk janë të punësuar në asnjë institucion shtetëror.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Mjetet dhe pajisjet e mesipërme janë kërkuar duke u bazuar në zerat përkatës të preventivit, sipas tabelës së mesipërme.

### **2.3.9. Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar:**

1 (një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili nga Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë".*

(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

**2.3.10.** Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) për “Grumbullim dhe transportim të mbejtjeve inerte (Kodi III.2.B);

**Argumentim:** Kërkesat e cilësisë të sipërcituara (kriteri 2.3.5 dhe kriteri 2.3.18 tek shtojca 7) janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*. Ndërsa përcaktimi i llojit të licencave nga ofertuesi, referuar natyrës së kontratës, bazohet në ligjin 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në VKM-në nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

**2.3.11.** Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë.

**Argumentimi:**

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, (pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të kriterit të sipërcituar lidhur me dhe drejtuesin teknik të punimeve, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës dhe mban përgjegjësi teknike dhe drejtuese për zbatimin e kontratës në mënyrë cilësore.

**2.3.12** Ofertuesi duhet të paraqesë grafikun e punimeve të firmosur dhe vulosur nga administratori. Grafiku i punimeve në përputhje me zërat e punës të jetë në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit, kjo në respektim të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”..